



## FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

05.12.2018

Për: **BOE : Murati, shpk & Sireta 2F, shpk & EURO-ALB, shpk : Murati** me nr. Nipti: **J66702413V, Sireta 2F me nr. Nipti:K51501008J,Euro-Alb me nr.Nipti:K66613407H**, adresa: **Tiranë**.

Procedura e prokurimit: **E hapur (Pune)**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-72671-05-31-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rivitalizim i Qendres Gose, Bashkia Rrogozhine”, kohëzgjatja e kontratës, 12 muaj nga lidhja e kontratës.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): **Buletini i Njoftimeve Publike, Date 04.06.2018, Nr.22**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Oferta e shoqërisë, **Murati, shpk & Sireta 2F, shpk & EURO-ALB, shpk : Murati** me nr. Nipti: **J66702413V, Sireta 2F me nr. Nipti:K51501008J,Euro-Alb me nr.Nipti:K66613407H** me vlerë të ofruar : **82.202.681** (tetedhjetë edy milion e dyqind e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një) leke pa tvsh.
2. Oferta e shoqërisë, **BE-ES, shpk & Aurora Konstruksion, shpk, BE-IS** me numër Nipti: **K71412003A, Aurora Konstruksion me nr.Nipti K02017003I**, me vlerë të ofruar : **70.274.995** (shtatëdhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e nentëqind enetëdhjetë e pesë) leke pa tvsh.
3. Oferta e shoqërisë, **KEGLI-DURI, shpk me nr.Nipti:K94016202U** me vlerë të ofruar : **82.950.403** (tetedhjetë e dy milion e nentëqind e pesëdhjetë mijë e katërqindetë) leke pa tvsh.
4. Oferta e shoqërisë, **Rafin Company, shpk me nr.Nipti:L52125110A** me vlerë të ofruar:**82.999.999**(tetedhjetë e dy milion e nentëqind e nentëdhjetë e nente mijë e nentëqind e nentëdhjetë e nente) leke pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

**Ka ofertues të skualifikuar.**

**Tre nga shoqëritë e tjera pjesëmarrëse në tender,**

**1. BOE: BE-IS, shpk & AURORA KOSTRUKSION, shpk**

**2.KEGLI-DURI, shpk**

**3.RAFIN COMPANY, shpk**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

1. Oferta e shoqërisë, BOE: **BE-ES, shpk & Aurora Konstruksion, shpk, BE-IS** me numer Nipti: **K71412003A, Aurora Konstruksion me nr.Nipti K02017003I**, me vlerë të ofruar : **70.274.995** (shtatëdhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e nentëqind e nëntëdhjetë e pesë) leke pa tvsh, **është refuzuar nga KVO-ja, për arsye se:**

**Bashkimi i operatoreve ekonomike “Be-Is shpk & Aurora Konstruksion shpk” nuk plotëson kriteret për kualifikim, si më poshtë sqaruar:**

1. Puna e ngjashme e paraqitur në tender nga operatori ekonomik “BE-IS” Sh.p.k. me objekt “Rikonstruksion i plote dhe shtese ambientesh në shkollën e mesme Qemal Stafa”, në kundërshtim me kërkesat për kualifikim dhe dokumentet e tenderit, nuk është e shoqëruar me asnjë faturë tatimore shitje të prera nga kjo shoqëri me institucionin me të cilin ka lidhur edhe kontratën, konkretisht Bashkinë Tiranë.

Pra, është paraqitur në tender një kontratë e cila përmban të dhëna jo të sakta për qëllime kualifikimi, pasi të gjitha faturat tatimore të shitjes për këtë kontratë janë prera nga shoqëria tjetër Aurora në masën 100%. Pra shoqëria BE&IS sh.p.k. nuk ka realizuar asnjë zë në këtë kontratë, ndërkohë që paraqitet në tender si punë e ngjashme e realizuar edhe nga kjo shoqëri.

2.Mjetet me targe AA794MG, AA816HO dhe AA112OD, e marre me qera nga shoqëria BE-IS sh.p.k tek shoqëria Oruci sh.p.k në datë 18.07.2018 nuk kanë kapacitetin mbajtës përkatësisht 8.5 ton, 8.04 ton dhe 9.9 ton, ndërkohë që nuk plotëson kërkesat për kualifikim, ku janë kërkuar mjete me kapacitet mbajtës 24-26 ton dhe 15-18 ton.

3. Kamioncina me targe AA112CJ e marre me qera nga shoqëria BE-IS sh.p.k. nga shoqëria Oruci sipas kontratës së qerave të lidhura me datë 18.07.2018, në kundërshtim me kërkesat për kualifikim nuk është e shoqëruar edhe me taksat e mjetit.

4. Mjeti me targe AA689TS i marre me qera nga shoqëria BE-IS tek Faik Kordhoku sipas kontratës së qerave të lidhura me datë 11.05.2018 është me kapacitet mbajtës 11.02 ton, ndërkohë që në kundërshtim me kërkesat për kualifikim nuk plotëson tonazhin e kërkuar në dokumentet e tenderit ku kërkohej me kapacitet mbajtës 15-18 ton.

5.CV e paraqitur në tender nga shoqëria Aurora Konstruksion sh.p.k. për inxhinierin Znj.M.Kristo

(Koco), eshte me nenshkrimin dhe vulen e shoqerise, nderkohe qe ky dokument permban te dhenat personale te personit te mesiperm. Gjithashtu, ne folderin e hedhur ne tender sqarohet se ky person eshte larguar, ndekohe qe ne tender paraqitet dokumentacioni i kerkuar, perfshire edhe libezen e punes date 17.10.2008.

6.Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria BE-IS sh.p.k. lidhur me mjetin me targe AA057NZ nuk eshte i sakte, pasi ne kundershtrim me kerkesat per kualifikim nuk eshte mjet veteshkarkues, si dhe kapaciteti mbajtes i ketij mjete eshte 0.99 ton, nderkohe qe ne kerkesat per kualifikim kerkohet kamioncine me kapacitet mbajtes 1-1.5 ton.

7. Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria BE-IS sh.p.k. lidhur me mjetin me targe TR 3094 U nuk eshte i sakte, pasi ne kundershtrim me kerkesat per kualifikim kapaciteti mbajtes i ketij mjete eshte 0.99 ton, nderkohe qe ne kerkesat per kualifikim kerkohet kamioncine me kapacitet mbajtes 1-1.5 ton. Gjithashtu, ne kundershtrim me dokumentet e tenderit, per kete mjet nuk eshte paraqitur ne tender fotot e tij.

8.Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria BE-IS sh.p.k. lidhur me mjetin me targe AA417JS nuk eshte i sakte, pasi ne kundershtrim me kerkesat per kualifikim kapaciteti mbajtes i ketij mjete eshte 18.5 ton, nderkohe qe ne kerkesat per kualifikim kerkohet kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 15-18 ton.

9.Lidhur me mjetin me targe AA782FA te paraqitur ne tender nga shoqeria BE-IS sh.p.k. konstatohet se ky mjet nuk eshte autobitumatrice, por eshte modifikuar si i tille, si dhe tek certifikata e kontrollit teknik viti eshte i palexueshem.

10. Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria BE-IS sh.p.k. per Z. G. Islamaj nuk eshte i sakte pasi, , certifikata e sigurimit teknik leshuar nga HTM e ka vlefshmerine per vitin 2017, nderkohe qe procedura e prokurimit eshte zhvilluar ne date 02.11.2018, pra eshte paraqitur ne tender nje dokument jo i sakte.

11. Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria BE-IS sh.p.k. per Sh.Islamaj nuk eshte i sakte pasi, nenshkrimi i Z. Sh. Islamaj ne kontraten e nenshkruar midis paleve me ate tek CV e paraqitur ne tender jane te ndyshme. Pra, jane paraqitur ne tender dy dokumenta te firmosura nga i njejti person, te cilat jane me nenshkrime te ndryshme, cka perben paraqitjen e dokumentit me te dhena jo te sakta.

12. Autobetonierja me targe AA117GL e paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. e marre me qera nga Ferro Beton&ConstructionCO, sipas kontrates se lidhur me date 15.07.2017, e ka kontrollin teknik te mjetit te vlefshme deri ne date 02.06.2018, nderkohe qe procedura e prokurimit eshte hapur ne date 02.11.2018. Gjithashtu, siguracioni i ketij mjete eshte i vlefshem deri ne date 18.05.2018, si dhe certifikata per transport mallrash e ka vlefshmerine deri ne date 20.10.2017,

nderkohe qe data e hapjes eshte 02.11.2018. Pra, jane paraqitur ne tender dokumenta te pavlefshme, si dhe shoqeria qeramarrese Aurora Kontrukcion sh.p.k. fsheh detyrimet ndaj shtetit, duke mos paguar taksat e mjetit te marre me qera.

13. Kontrata e punes e paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Kontrukcion me Z.E Xhepa me profesion hekurkthyes, lidhur ne date 01.01.2018 ne kundershtim me legjislacionin ne fuqi, nuk kane te percaktuar pagen, mbi bazen e te ciles do te paguhet ky person.

14. Kontrata e punes e paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Kontrukcion me Z.MVolaj me profesion Arkitekthe, lidhur ne date 19.01.2018 ne kundershtim me legjislacionin ne fuqi, nuk kane te percaktuar pagen, mbi bazen e te ciles do te paguhet ky person.

15. Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Kontrukcion sh.p.k. per Z. F.Baraku si teknik ndertimi, sipas kontrates se lidhur me date 07.04.2017 rezulton se, dokumentacioni i paraqitur ne tender si teknik ndertimi, ne kundershtim me kerkesat per kualifikim nuk eshte leshuar nga institucione shtetore. Gjithashtu, referuar dokumentacionit te paraqitur ne tender nga kjo shoqeri konstatohet se, nenshkrimi i Z. F. Baraku ne kontraten e lidhur me shoqerine Aurora Kontrukcion sh.p.k. me nenshkrimin e po ketij personi ne CV e paraqitur, rezulton se nenshkrimet ne keto dokumenta jane te ndryshme, cka perben rastin e paraqitjes ne tender te dokumentacionit me te dhena jo te sakta.

16. Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Kontrukcion sh.p.k. per Z. B. Bregasi si teknik Mekanik, sipas kontrates se lidhur me date 01.06.2018 rezulton se, dokumentacioni i paraqitur ne tender si teknik mekanik, ne kundershtim me kerkesat per kualifikim nuk eshte leshuar nga institucione shtetore.

17. Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Kontrukcion sh.p.k. per Z. S.Keco nuk eshte i sakte pasi, ne kundershtim me kerkesat per kualifikim eshte paraqitur ne tender nje kurs trajnimi si drejtues teknik, nderkohe qe eshte kerkuar nga institucione shtetore. Gjithashtu, data e lindjes se ketij personi sipas kursit te trajnimit eshte percaktuar 02.09.1995, nderkohe sipas certifikates se sigurimit teknik leshuar nga EMCO pecaktohet datelindja 02.09.1955, ku kjo e fundit eshte edhe pa vule. Pra nga ana e kesaj shoqerie jane paraqitur ne tender dokumenta me informacion jo te sakta.

18. Nga ana e shoqerise Aurora Kontrukcion sh.p.k. eshte paraqitur ne tender per Znj. T. Kociu edhe licensa e zbatimit, nderkohe qe nje dokument i tille nuk egziston qe nga vitit 2008, pasi qe nga kjo periudhe kohore egzistojne licensat e shoqerive, nderkohe qe licensat e zbatimit jane shfuqizuar, si dhe duhej te ishin dorezuar prane institucionit kompetent. Pra, eshte paraqitur ne tender nje dokument qe permban te dhena jo te sakta, per nje dokument i cili nuk egziston juridikisht.

19. Ne kundershtim me dokumentet e tenderit si dhe me kerkesat per kualifikim, nuk eshte paraqitur ne tender grafiku i punimeve, lidhur me pjesen qe do te kryhet nga shoqeria Aurora Kontrukcion sh.p.k. e

cila sipas kontrates se bashkepunimit ka marre persiper te realizoje 40% te punimeve. Ne keto kushte, duke qene se per analogji edhe per procedurat e paraqitura ne tender si pune te ngjashme, ku keto dy shoqeri kane bashkepunuar, faturat tatimore jane prere vetem nga nje shoqeri, cka provon dhe verteton fiktivitetin lidhur me bashkimin e ketyre dy shoqerive.

20. Referuar listpagesave te paraqitura ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. konstatohet se A. Selimaj figuron si i siguruar mbi pagen 6,000 leke, nderkohe qe sipas kontrates se nenshkuar midis paleve date 01.06.2018 eshte rene dakort qe paga e ketij personi do te jete 23,000 leke, ne kundershtim kjo me nenin 45/2/d/dh te LPP. Pra, ndodhemi perpara rastit te fshehjes se detyrimeve ndaj shtetit.

21. Sipas dokumentacionit te paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. per drejtuesin teknik Ing. G.Hasko me profesion gjeodet konstatohet se, se pari ky person figuron i punesuar ne fakultetin e Inxhinierise se Ndertimit, nderkohe qe ndalohet kategorikisht punesimi i drejtuesve teknik ne institucione te tjera shteterore apo private. Gjithashtu, ky drejtues teknik figuron ne listpagesa si i siguruar vetem per 10 dite me pagen 5,000 leke, ne kundershtim kjo me kontraten e nenshkuar midis paleve.

22. Sipas listpagesave te paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. per Z. B. Bregasi rezulton se ky person nuk figuron si i siguruar ne listpagesa, ne kundershtim kjo me nenin 45/2/d te LPP, pra duke u ndodhur perpara rastit te mospagimit te detyrimeve per sigurimet shoqerore dhe shendetesore.

23. Sipas dokumentacionit te paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. per Z. F. Baraku konstatohet se, sigurimet per kete person paguhen mbi pagen 60,000 leke, nderkohe qe sipas kontrates se punes te paraqitur ne tender te lidhur date 07.04.2017 eshte rene dakort qe paga do te jete 23,000 leke, cka perben rastin e paraqitjes ne tender te kontrates me te dhena jo te sakta.

24. Sipas dokumentacionit te paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. per Z. G. Ceta me profesion hidraulik konstatohet se, sigurimet per kete person paguhen mbi pagen 30,000 leke, nderkohe qe sipas kontrates se punes te paraqitur ne tender eshte rene dakort qe paga do te jete 23,000 leke, cka perben rastin e paraqitjes ne tender te kontrates me te dhena jo te sakte. Gjithashtu, referuar listpagesave te kesaj shoqerie, rezulton se ky person sigurohet mbi numrin e sigurimit 7126.03.

25. Sipas dokumentacionit te paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. konstatohet se, Znj. M. Kristo me profesion topograf, nuk figuron si e siguruar prane kesaj kompanie, ne kundershtim kjo me nenin 45/2/d/dh te LPP.

26. Sipas dokumentacionit te paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. konstatohet se, Znj. A. Gramos me profesion Ing ne ndertim, nuk figuron si e siguruar prane kesaj kompanie, ne kundershtim kjo me nenin 45/2/d/dh te LPP.

27. Sipas dokumentacionit te paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. konstatohet se, Z. Sh. Fejzullah me profesion saldator, nuk figuon si i siguruar prane kesaj kompanie, ne kundershtim kjo me nenin 45/2/d/dh te LPP.

28. Sipas dokumentacionit te paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. konstatohet se, Z. P. Muca me profesion mekanik, nuk figuon si i siguruar prane kesaj kompanie, ne kundershtim kjo me nenin 45/2/d/dh te LPP.

29. Sipas dokumentacionit te paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. per Z. E. Xhangolli me profesion teknik hidraulik konstatohet se, ne kundershtim me dokumentet e tenderit nuk eshte paraqitur libreza e punes.

30. Lidhur me mjetin e marre me qera nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. me targe AA852SF, konstatohet se kontrolli teknik i ketij mjeti eshte i vlefshem deri ne date 22.08.2018, si dhe siguracioni i mjetit eshte i vlefshem deri ne date 24.08.2018, nderkohe qe procedura e prokurimit eshte hapur ne date 02.11.2018. Pra, referuar dokumentacionit te paraqitur ne tender, kjo shoqeri nuk paguan detyrimet lidhur me mjetin e mesiperm, duke fshehur detyrimet ndaj shtetit.

31. Kamioni i paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. me targe AA205BV i marre me qera nga A. Cela eshte me kapacitet mbajtes 29.5 ton, ne kundershtim kjo me kekesat per kualifikim ku kerkohet kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 24-26 ton.

32. Mjeti i marre me qera nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. me targe AA654NR nga Gezim Roci date 17.05.2018, e ka kontrollin teknik te mjetit te vlefshem deri ne date 10.08.2018, si dhe siguracionin te vlefshem deri ne date 04.08.2018, nderkohe qe tenderi eshte hapur ne date 02.11.2018. Pra, jane paraqitur ne tender dokumenta te cilat provojne se nuk paguhen detyrimet ndaj shtetit nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k.

33. Mjeti i marre me qera nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. me targe AAR212 nga G. Roci, date 17.05.2018 rezulton se eshte me kapacitet mbajtes 33.4 ton, ne kundershtim kjo me kerkesat per kualifikim, ku eshte kerkuar kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 24-26 ton.

34. Mjeti i paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion shpk me targe AA136FS e ka kontrollin teknik te mjetit te vlefshem deri ne date 03.02.2018, kurse siguracionin e ka te vlefshem deri ne date 09.01.2018, nderkohe qe procedura e prokurimit eshte hapur ne date 02.11.2018. Referuar sa me sipër, ndodhemi perpara rastit te fshehjes se pagimit te detyrimeve ndaj shtetit.

35. Mjeti i paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. me targe TR4032R, e ka siguracionin te vlefshem deri ne date 27.09.2018, kurse certifikata e transportit te mallrave eshte e

vlefshme deri ne date 12.10.2018, nderkohe qe procedura e prokurimit eshte hapur ne date 02.11.2018. Referuar sa me siper, ndodhemi perpara rastit te fshehjes se pagimit te detyrimeve ndaj shtetit.

36. Mjeti i paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. me targe AA675LA, e ka certifikaten e transportit te mallrave te vlefshme deri ne date 12.10.2018, nderkohe qe procedura e prokurimit eshte hapur ne date 02.11.2018. Referuar sa me siper, ndodhemi perpara rastit te fshehjes se pagimit te detyrimeve ndaj shtetit.

37. Nje nga mini eskavatoret e paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. marre me qera nga Jolan Hoxha date 12.05.2018, ne kundershkrim me kerkesat per kualifikim eshte pa foto.

38. Nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. eshte paraqitur ne tender nje folder per Znj. M.Kristo duke percaktuar larguar, nderkohe jane paraqitur ne tender te gjitha dokumentet per kete person. Sipas CV te paraqitur rezulton se ky dokument eshte me vule dhe firme te ketij operatori ekonomik, nderkohe qe ky dokument permban te dhena personale.

39. Te gjitha kontratat e punes te paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. per A. Xhaja, I. Sita, A. Hoxha, G. Keco, K. Shala, L. Cela, M. Pirro, konstatohet se jane me te njejtin shkrim te personave qe kane nenshkruar kontratat, duke vendosur ne fund vetem emer dhe mbiemer, por pa nenshkrimet e tyre.

40. Referuar dokumentacionit te paraqitur ne tender nga shoqeria Auriora Konstruksion sh.p.k. per mjeken M. Shehu konstatohet se CV e paraqitur eshte me firme dhe vule te shoqerise, nderkohe qe ky dokument permban te dhena personale.

41. Nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. eshte paraqitur ne tender si pune e ngjashme objekti i lidhur me Bashkine Lushnje me vlere 34,561,074 leke me TVSH, sipas formularit te vleresimit te paraqitur. Po sipas ketij formulari vleresimi percaktohet se, punimet kane perfunduar ne date 30.07.2017, si dhe sipas akt kolaudimit parashikohet se punimet kane perfunduar ne date 03.07.2017, nderkohe qe fatura tatimore nr. 139, per punimet e realizuara eshte prere ne date 30.06.2017. Pra nga kjo shoqeri jane paraqitur ne tender dokumenta te cilat nuk perputhen me njera tjetren.

42. Kontratat e punes te paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. per A. Cela, B. Qershija dhe H.Lleshi me profesion murator dhe hekurkthyes jane kontrata ku nenshkrimet e tyre nuk perputhen sipas dokumentacioneve te paraqitura ne tender.

43. Puna e ngjashme e paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. me objekt Rikualifikimi i sheshit Rilindja dhe Fasadave Erseke, sipas formularit te vleresimit percaktohet se vlera e realizuar eshte 55,588,008 leke me TVSH. Sipas akt kolaudimit te paraqitur ne tender konstatohet se punimet kane perfunduar ne date 16.09.2016, nderkohe qe situacionet pjesore per realizimin e punimeve

jane prere sipas faturave tatimore edhe ne date 04.10.2016 dhe 28.11.2016. Pra, jane paraqitur ne tender dokumenta me informacion jo te sakt, te cilat nuk perputhen me njera tjetren.

44. Lidhur me dokumentacionin e paraqitur ne tender nga shoqeria BE-IS sh.p.k. per Z. P.Dema konstatohet se eshte paraqitur ne tender nje kontrate pa afat. Gjithashtu, eshte paraqitur nje dokument si teknik ndertimi leshuar nga HTM, nderkohe qe ne kundershtim me kerkesat per kualifikim nuk eshte leshuar nga institucion shteteror. Lidhur me dokumentacionin per deftesen e pjekurise konstatohet se nga noteri nuk eshte percaktuar se kush dokument noterizohet, ne kundeshtim kjo me ligjin per noterine, ku noterizimi per cdo dokument, behet me dokument te vecante. Sipas CV se paraqitur ne tender nuk percaktohet se ky eshte nje punonjes i kesaj shoqerie, si dhe nenshkrimi i Z. P. Dema ne CV eshte i ndryshem nga nenshkrimi me kontraten e punes se lidhur ne date 21.06.2017, pra duke u ndodhur perpara rastit te paraqitjes se nje dokumenti me te dhena jo te sakta. Gjithashtu, libreza e punes e paraqitur ne tender per kete person eshte e palexueshme.

45. Lidhur me dokumentacionin e paraqitur ne tender nga shoqeria BE-IS sh.p.k. per teknikun e ndertimit I. Islamaj konstatohet se, ne kundershtim me dokumentet e tenderit, certifikata e sigurimit teknik leshuar nga HTM eshte e vlefshme deri ne vitin 2017, nderkohe qe procedura e prokurimit eshte hapur ne date 02.11.2018. Libreza e punes e paraqitur per kete person eshte e palexueshme. Nenshkrimi i CV nga Z. I. Islamaj eshte i ndryshem nga nenshkrimi i kontrates se punes, cka sjell si pasoje paraqitjen ne tender te nje dokumenti me te dhena jo te sakta. Gjithashtu, CV e paraqitur ne tender eshte e paplote.

46. Lidhur me dokumentacionin e paraqitur ne tender nga shoqeria BE-IS sh.p.k. per Z.E.Islamaj rezulton se nuk eshte i sakte pasi kontrata e paraqitur midis paleve ne kundeshtim me kerkesat per kualifikim, nuk ka paraqitur ne tender asnje dokument te leshuar nga institucion shteteror qe te provoje dhe vertetoje se eshte teknik ndertimi. Certifikata e sigurimit teknik e leshuar nga HTM mbaron ne vitin 2017, nderkohe qe tenderi eshte hapur ne date 02.11.2018. Libreza e punes e paraqitur ne tender eshte e palexueshme, si dhe ne kundershtim me dokumentet e tenderit nuk eshte paraqitur CV.

47. Lidhur me kontraten e ngjashme te paraqitur ne tender nga shoqeria BE-IS sh.p.k. me objekt Rehabilitimi uban i sheshit zaranika dhe bulevardit A. Pasha me Bashkine Elbasan konstatohet se, vlere totale e kesaj kontrate eshte 118,504,489 leke me TVSH. Referuar faturave tatimore te paraqitura ne tender, kjo shoqeri ka prere vleren totale prej 118,504,489 leke me TVSH. Nderkohe, sipas formularit te vleresimit te leshuar nga Bashkia Elbasan vertetohet se kjo shoqeri ka realizuar 87% te punimeve, nderkohe qe ka paraqitur fatura tatimore per vleren 100% te saj. Ne keto kushte, kjo shoqeri ka paraqitur ne tender dokumentacion qe permban te dhena jo te sakta per qellime kualifikimi.

48. Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria BE-IS sh.p.k. per hidraulikun Z.Sh. Kola nuk eshte i sakte dhe permban te dhena jo te sakt pasi nenshkrimi i ketij pesoni ne kontraten e lidhur midis paleve date 21.06.2017 eshte i ndryshem nga nenshkrimi ne CV e paraqitur. Gjithashtu, kontrata e



nenshkruar midis paleve ne kushtet kur eshte kontrate pa afat, Sipas librezes se punes te paraqitur ne tender konstatohet se ky person eshte punesuar ne kete shoqeri ne date 05.04.2016, nderkohe qe kontrata eshte lidhur ne date 21.06.2017.

49. Lidhur me dokumentacionin e paraqitur ne tender nga shoqeria BE-IS sh.p.k. per Z. Z.Zyberaj konstatohet se nuk eshte paraqitur CV.

50. Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria BE-IS sh.p.k. per Rahman Krasniqi nuk eshte i sakte pasi certifikata e sigurimit teknik skadon ne vitin 2017, nderkohe qe procedura e prokurimit eshte zhvilluar ne date 02.11.2018. Gjithashtu, nenshkrimi i ketij personi ne CV e paraqitur ne tender eshte i ndryshem nga nenshkrimi ne kontraten e punes, cka sjell si pasoje paraqitjen ne tender te nje dokumenti jo te sakte.

51. Kamioni me targe AA663LD i paraqitur ne tender nga shoqeria BE-IS sh.p.k. i marre me qera nga shoqeria Ferraj eshte me kapacitet mbajtes 12.1 ton, nderkohe qe ne kerkesat per kualifikim kerkohet me kapacitet mbajtes 15-18 ton.

52. Kamioni me targe AA195PK i marre me qera nga shoqeria BE-IS sh.p.k. tek shoqeria Ferraj rezulton se kontrolli teknik i ketij mjeti eshte i vlefshem deri ne date 18.09.2018, si dhe siguracioni i tij eshte i vlefshem deri ne date 15.09.2018, nderkohe qe tenderi eshte zhvilluar ne date 02.11.2018. Pra nga ana e kesaj shoqeri jane paraqitur ne tender dokumenta te cilat provojne dhe vertetojne se nuk paguan detyrimet ndaj shtetit.

53. Lidhur memjetet e marra me qera nga shoqeria BE-IS sh.p.k. tek shoqeria Babasi 2 sh.p.k. konstatohet se kamionin me targe AA459TJ kapaciteti mbajtes eshte 21.9 ton, ne kundershtim kjo me kerkesat per kualifikim ku kerkohet me kapacitet mbajtes 24-26 ton. Gjithashtu, lidhur me kete mjet konstatohet se ne kundershtim me kerkesat per kualifikim nuk eshte paraqitur ne tender siguracioni i detyrueshem, si dhe kotrolli teknik i tij, por jane paraqitur ne tender letra te nje mjeti tjeter me targe VL0651C, cka provon mos pagimin e detyrimeve nga shoqeria BE-IS per mjet e marra me qera.

54. Gjysem rimorkio e paraqitur ne tender nga shoqeria BE-IS e marre me qera nga shoqeria Babasi 2 sh.p.k. me targe ABR994 eshte me kapacitet mbajtes 31.6 ton, nderkohe qe ne kerkesat per kualifikim kerkohet me kapacitet mbajtes 24-26 ton.

55. Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria be&is per mjetin e marre me qera nga shoqeria babasi 2 me targe AA581AS nuk eshte i sakte pasi siguracioni i detyrueshem i ketij mjeti eshte i vlefshem deri ne date 11.10.2018, nderkohe qe tenderi eshte hapur ne date 02.11.2018.

56. Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria be-is sh.p.k. per mjetin e marre me qera nga shoqeria babasi 2 me targe ABR747 nuk eshte i sakte pasi siguracioni i detyrueshem i ketij mjeti eshte i vlefshem deri ne date 22.07.2018, nderkohe qe tenderi eshte hapur ne date 02.11.2018. Gjithashtu,

kapaciteti mbajtes i ketij mjeti eshte 30.4 ton, nderkohe qe ne kekesat per kualifikim kerkohet me kapacitet mbajtes 24-26 ton.

57. Mjeti i marre me qera nga shoqeria be&is me targe ABR859 tek shoqeria babasi 2 eshte me kapacitet mbajtes 38.1 ton, ne kundershkrim kjo me kekesat per kualifikim ku kerkohet me kapacitet mbajtes 24-26 ton.

58. Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria be&is sh.p.k. per mjetin e marre me qera nga shoqeria babasi 2 me targe AA203GY nuk eshte i sakte pasi siguracioni i detyrueshem i ketij mjeti eshte i vlefshem deri ne date 16.07.2018, si dhe kontrolli teknik i vlefshem deri ne date 20.07.2018 nderkohe qe tenderi eshte hapur ne date 02.11.2018, pra duke mos paguar detyrimet ndaj shtetit.Gjithashtu, certifikata per transport mallrash e leshuar nga bashkia per kete mjet eshte e vlefshme deri ne date 13.09.2018, nderkohe tenderi eshte zhvilluar date 02.11.2018. Pra kjo shoqeri, nuk paguan detyrimet ndaj shtetit per mjetet e marra me qera nga shoqeria babasi 2 sh.p.k.

59. Mjeti gjysem rimorkio me targe AAR683 i marre me qera nga shoqeria be&is sh.p.k. tek shoqeria babasi 2 sh.p.k. eshte me kapacitet mbajtes 29.8 ton, nderkohe qe ne kerkesat per kualifikim kerkohet me kapacitet mbajtes 24-26 ton. Gjithashtu, siguracioni i detyrueshem i ketij mjeti eshte i vlefshem deri ne date 20.07.2018, si dhe kontrolli teknik i vlefshem deri ne date 24.07.2018 nderkohe qe tenderi eshte hapur ne date 02.11.2018, pra duke mos paguar detyrimet ndaj shtetit per mjetet e marra me qera.

60.Kontratat e punes te paraqitura ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. per punonjesit G. Dyrma, I. Mucollari, Sh. Gjeci, B. Lami, L. Brisku, Sh. Fejzyllah, A. Germeni, F. Capi, S. Lami E. Zere, K.Nezha, M. Selimaj jane ne fund te gjitha me te njejtin shkrim, ku ne asnje rast asnje prej personave te mesiperem nuk nenshkruan me firmen e vete, cka sjell dyshim ne paraqitjen e ketyre dokumentacioneve, jo te sakta.

61. Kontrata e punes e paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion per G. Dyrma nuk eshte paraqitur ne tender asnje dokumentacion qe te provoje dhe vertetoje se ky person eshte pllakashtrues.

62. Kontrata e punes e paraqitur ne tender nga shoqeria aurora konstruksion shpk per Z. I.Mucollari konstatohet se mungon dokumenti nga noteri qe verteton se certifikata ne gjuhe te huaj eshte e njejte me origjinalin, si dhe mungon noterizimi i perkthimit.

E njehta gje si me siper vlen edhe per dokumentacionin e Z.Sh.Gjeci.

63. Ne kundershkrim me shtojcen e kerkuar ne kerkesat per kualifikim mbi kontratat e lidhura dhe ose ne proces, nga shoqeria aurora konstruksion sh.p.k. nuk jane deklaruar shume kontrata qe kjo shoqeri ka, nder to edhe kontrata me ARRSH, me fond limit 372,739,264 leke ku kjo shoqeri eshte shpallur fituese, date 20.09.2018, duke paraqitur ne tender nje dokument qe permban te dhena jo te sakta per qellime kualifikimi.

64. Deklarata e dhene nga shoqeria aurora konstruksion sh.p.k. per mjetet qe nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera jo e sakte, pasi kjo shoqeri i ka te angazhuara mjetet jo vetem me kontraten e lidhur me ARSH date 20.09.2018, por edhe per kontratat e lidhura me Agjencine e ofrimit te sherbimeve publike te integruara, date 29.10.2018, kontraten e lidhur me bashkine kurbine date 04.09.2018, kontraten e lidhur me bashkine Permet date 24.09.2018 etj.

Gjithashtu, si rezultat kjo shoqeri i ka te angazhuar edhe stafin teknik dhe te gjithe punonjset ne keto kontrata.

65. Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria aurora konstruksion sh.p.k. per Z. A.Germenji nuk eshte i sakte pasi nuk ka paraqitur ne tender asnje dokumentacion qe te vertetoje dhe proveje se eshte specialist kondicionimi.

66. Lidhu me dokumentacionin e paraqitur ne tender nga shoqeria aurora konstruksion per E. Zere konstatohet se certifikata e sigurimit teknik skadon ne date 13.07.2018, nderkohe qe tenderi eshte zhvilluar date 02.11.2018.

67. Grejderi me goma i marre me qera nga shoqeria be&is sh.p.k. nuk shte i shoqeruar me dokumentacionin e kerkuar ne kerkesat per kualifikim, si dhe dokumentacioni shoqerues eshte ne gjuhe te huaj, ne kundershtrim me dokumentet e tenderit.

68. Ky bashkim operatoresh ekonomike nuk ka paraqitur ne tender asnje gjenerator 68kva.

69. Ne kundershtrim me shtojcen e kerkuar ne kerkesat per kualifikim mbi kontratat e lidhura dhe ose ne proces, nga shoqeria BE-IS sh.p.k. nuk jane deklaruar shume kontrata qe kjo shoqeri ka, nder to edhe kontrata me bashkine Tirane etj, duke paraqitur ne tender nje dokument qe permban te dhena jo te sakte per qellime kualifikimi.

70. Iso e paraqitura ne tender nga shoqeria BE-IS sh,pk 9001, 14001, 18001 etj jane leshuar nga organizma, te cilat nuk jane te akredituara ne republiken e shqiperise.

71. Shoqeria be&is ka paraqitur ne tender kontraten e punes me drejtuesin teknik L. Daci, E. Alla, Xh. Cela, A.Myftaraj ne te cilen mungon paga e ketyre inxhinierëve.

72. Shoqeria be&is ka paraqitur ne tender edhe licensen e zbatimit per H. Islamaj, A. Myftaraj, B. Alla nderkohe qe licensa te tilla zbatimi nuk egzistojne.

73. Sipas listpagesave te paraqitura ne tender nga shoqeria aurora konstruksion per Sami Uku, konstatohet se ky person sigurohet mbi numrin 7126.03, nderkohe qe numer i tille nuk egziston.

74. Sipas dokumentacionit te paraqitur ne tender nga shoqeria aurora konstruksion per T. Kociu konstatohet se ky person sigurohet mbi pagen 60,000 leke, nderkohe qe ne tender eshte paraqitur edhe kontrata e punes e lidhur date 10.04.2015 ku percaktohet paga pej 50,000 leke. Pra, kontrata e punes permban te dhena te rreme.

75. Sipas dokumentacionit te paraqitur ne tender nga shoqeria aurora konstruksion sh.p.k. konstatohet se sigurimet per I. Thanasi paguhen per pagen 6,000 leke, nderkohe qe sipas kontrates se bashkepunimit te lidhur date 01.06.2018 shte rene dakort qe paga do te jete 23,000 leke, duke fshehur detyrimet ndaj shtetit, ne kundeshitim me nenin 45/2/d/dh te LPP.

76. E njejta gje per analogji, per fshehje te detyrimeve ndaj shtetit nga shoqeria aurorar konstruksion eshte edhe per A. Gagushi, A. Greca, N. Dragoti, F. Balliu, G. Malo, L. Tafa, O. Selimaj, E. Xhepa, E. Xhangolli, M. Kukli, E. Gjeka, ku nuk peputhen paga mbi bazen e te cilave paguhen sigurimet, me pagat e rena dokort sipas kontratave te nenshkruara.

77. Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria aurora konstruksion sh.p.k. per inxhinierin mekanik V. Jaupllari nuk eshte i sakte pasi sigurimet per kete person paguhen mbi pagen 14,350 leke, nderkohe qe sipas kontrates se lidhur midis paleve ne date 31.03.2015 eshte rene dakort per pagen 30,000 leke.

78. Kontratat e punes te paraqitur ne tender nga shoqeria aurora konstruksion per A. Xhaja, I. Sita, A. Hoxha, G. Keco., K. Shala, L. Cela, M. Pirro, M. Shehu, A. Cela nuk jane te sakta, pasi palet kane rene dakort per paga te ndryshme me sa ata figurojne ne listpagesa, duke paraqitur ne tender dokumentacione me informacion jo te sakte.

79. Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. per muratoin B. Qershija nuk eshte i sakte pasi ky person figuron i siguar mbi pagen 6,000 leke, nderkohe qe sipas kontrates se punes palet kane rene dakort per pagen 23,000 leke, ne kundeshitim me nenin 45/2/d te LPP.

80. Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. per hekurkthyesin H. Lleshi nuk eshte i sakte pasi ky person figuron i siguar si murator sipas numrit te sigurimeve 7112.05, nderkohe qe ne tender paraqitet si hekurkthyes.

81. Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. per S. Lami nuk eshte i sakte pasi ky person figuron i siguar mbi pagen 6,000 leke, nderkohe qe sipas kontrates se punes palet kane rene dakort per pagen 23,000 leke, ne kundeshitim me nenin 45/2/d te LPP.

82. Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. per K. Nezha nuk eshte i sakte pasi ky person figuron i siguar mbi pagen 6,000 leke, nderkohe qe sipas kontrates se punes palet kane rene dakort per pagen 23,000 leke, ne kundeshitim me nenin 45/2/d te LPP.

83. Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. per M. Selimaj nuk eshte i sakte pasi ky person figuron i siguar mbi pagen 6,000 leke, nderkohe qe sipas kontrates se punes palet kane rene dakort per pagen 23,000 leke, ne kundersizim me nenin 45/2/d te LPP. Gjithashtu, referuar numrit te sigurimit ne listpagesa konstatohet se ky person sigurohet si puntor krahu ne ndertim godinash, nderkohe ne tender paraqitet si suvatures, duke paraqitur ne kete menyre dokumentacion me informacion jo te sakte per qellime kualifikimi.

84. Per Z. P. Muca sipas folderit te hedhur ne tender shoqeria Aurora Konstruksion sqaron se eshte person i larguar, nderkohe qe ka paraqitur ne tender dokumentacionin per kete mekanik.

85. Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. per mjetin autokulle me targe AA982OG, i marre me qera nga D&KO ne date 31.10.2018 nuk eshte i sakte, pasi kontrata e qerese percakton nese kjo shoqeri do te shpallet fituese, pra mjeti nuk eshte mare me qera, siguracioni i detyrueshem i ketij mjeti eshte i palexueshem, si dhe noteri ka noterizuar dokumenta te noterizuara me pare, ku nder te tjera ka noterizuar edhe fotot te njejta me origjinalin, veprime te cilat provojne mbi fiktivitetin e kesaj kontrate.

86. Certifikatat ISO te paraqitura ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. nuk provojne me dokumentacion se jane akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

87. Drejtuesi teknik I. Kola i shoqerise Aurora Konstruksion sh.p.k. figuron i siguar mbi pagen 40,000 leke ne muaj sipas disa listpagesave te paraqitura ne tender, nderkohe qe kontrata e punes parashikon 50,000 leke ne muaj.

88. Pothuajse te gjitha certifikimete paraqitura ne tender nga shoqeria Auora Konstruksion sh.p.k. leshuar nga kompania EMCO jane nga nje kompani e pezulluar, si dhe jane pa vule te kesaj kompanie.

89. Lidhur me mjetin kamioncine me targe TR4897G, te paraqitur ne tender nga shoqeria aurora konstruksion shpk konstatohet se leja e qarkullimit te ketij mjeti eshte pothuajse e palexueshme, te gjitha dokumentat shoqerues te ketij mjeti jane fotokopje ku mungon dokumenti i noterit qe verteton se kopja eshte e njejte me origjinalin, si dhe nuk eshte paraqitur asnje dokumentacion provues qe kjo shoqeri paguan nepermjet sistemit bankar cdo muaj nga 20,000 leke per kete mjet, i cili shte marre me qera qe nga data 12.09.2016.

90. Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria Auora Konstruksion shpk per drejtuesin teknik I. Gjikondi, X. Kacani, G. Malindi, A. Haxhia, A. Myftiunuk eshte i sakte pasi kontrata e nenshkruar midis paleve nuk ka te percaktuar pagen e ketij personi, CV e paraqitur eshte me firme dhe vule te shoqerise nderkohe qe ky dokument permban te dhenat pesonale, si dhe eshte paraqitur ne tender license zbatimi, ndekohe qe licensa te tilla nuk egzistojne.

91. Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria aurora konstruksion per drejtuesin teknik J. Kero eshte jo i sakte, pasi nenshkrimi i administratorit te shoqerise nuk eshte i njejte ne ate qe ka nenshkuar ne kontraten e lidhur midis paleve dhe CV se ketij personi.

92. Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria BE-IS shpk per mjetin me targe AA176NH, i marre me qera nga shoqeria Kastrati si autobot uji, eshte jo i sakte, pasi ky mjet nuk eshte autobot uji por mjet per transportin e lendeve te rrezikshme.

93. Certifikata ISO 8000:2014 e paraqitur ne tender nga shoqeria Aurora Konstruksion eshte jo e sakte, pasi jo vetem eshte pa firme perkthyesi, por eshte leshuar nga nje organizem i cila nuk rezulton i akredituar.

94. Dokumentacioni i paraqitur ne tender nga shoqeria aurora konstruksion per A. Gagushi, A. Greca, N. Dragoti, nuk eshte i sakte pasi certifikata e trajnimit ne gjuhen e ofertes nuk eshte me firme perkthyesi, si dhe mungon nenshkrimi i noterit qe verteton perkthimin.

95. Ky bashkim operatoresh ekonomike, nuk ploteson ne raport me perqindjen e marre sipas kontrates se bashkepunimit, mjetet e kerkuara ne kerkesat per kualifikim, sipas zerave konkrete te marre persiper, ne kundeshim me LPP.

96. Ne kundershtim me piken 2.2.5 te kerkesave per kualifikim, ky bashkim operatoresh ekonomike nuk ka paraqitur ne tender deklarate me shkrim nga administratori qe AK rezervon te drejten te verifikojte vertetesine e deklarates sipas pikes 2/2.4.

97. Ne kundershtim me kriteret specifike per kualifikim, operatori ekonomik aurora konstruksion sh.p.k. nuk ka paraqitur ne tender deklaraten, sipas kerkeses te pikes 2/3.4.

98. Ne kundershtim me dokumentet e tenderit, shoqeria aurora konstruksion nuk ka paraqitur ne tender deklaraten mbi verifikimin e vertetesise ne rast te deklarimit te rreme.

99. Shoqeria aurora konstruksion, nuk ka paraqitur ne tender deklaraten sipas percaktimit te pikes 2/3.5/1 te kekesave per kualifikim.

100. Shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. ne kundershtim me kerkesat per kualifikim, nuk ka paraqitur ne tender deklaratat e kerkuara sipas pikes 2/3.8.

101. Te dy operatoret ekonomike, kane paraqitur ne tender lidhur me punet ne proces informacion te paplote, duke mos deklaruarne kete menyre informacionin mbi angazhimin ne kontrata te tjera te punonjesve dhe makinerive, pra kane paraqitur ne tender nje deklarate qe permban te dhena te jo te sakta per qellime kualifikimi.

102. Shoqeria aurora konstruksion, nuk ploteson ne raport me perqindjen e marre persiper sipas kontrates se bashkepunimit, tekniket e mesem te kerkuar.

103. Shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. nuk ka paraqitur ne tender deklaratat e kerkuara ne piken 2/3.14 te kerkesave per kualifikim.

104. Shoqeria Aurora Konstruksion sh.p.k. nuk ploteson kerkesen mbi numrin e punonjesve te kerkuar, pasi te gjitha punonjesit e kesaj shoqerie jane te angazhuar ne ADISA, Bashkine Kurbin, Bashkine Permet, si dhe ne ARRSH, duke paraqitur ne tender informacion jo te sakte per qellime kualifikimi, pasi nuk disponon asnje punonjes per kete objekt.

E njejta gje vlen per analogji per stafin drejtues teknik edhe makinerite, ku dokumentacioni i paraqitur ne tender eshte jo i sakte.

E njejta situatë eshte edhe per shoqerine BE-IS sh.p.k te ketij bashkimi operatoresh ekonomike, i cili i ka te angazhuar te gjitha kapacitetet teknike, makinerite dhe punonjesit ne kontrata te lidhura me Bashkine Tirane.

Sipas pergjigjes se AK, me te cilin shoqeria Be-Is sh.p.k. ka lidhur edhe kontrate, konstatohet se i gjitha stafi teknik i kesaj shoqerie eshte i angazhuar ne kete objekt ku ka nenshkruar edhe kontrate, duke deklaruar edhe ne kete institucion qe te gjitha punonjesit do te qendrojne ne kete objekt, nderkohe qe nje deklarate e tille eshte paraqitur edhe ne kete procedure. Pra, kjo shoqeri i ka te gjitha kapacitetet te zena ne objekt tjeter.

E njejta gje sqarohet edhe per makinerite, te cilat figurojne ne kontraten tjeter te lidhur.

2. Oferta e shoqerise, **KEGLI-DURI, shpk me nr.Nipti:K94016202U** me vlere te ofruar : **82.950.403** (tetedhjete e dy milion e nenteqind e pesedhjete mije e katerqindetre) leke pa tvsh , eshte refuzuar per arsyet e meposhtme:

**Operatori ekonomik “Kegli-Duri ” Shpk nuk ploteson kriteret per kualifikim, sipas shtojces 12 te DST me poshte sqaruar:**

Shoqeria Kegli-Duri sh.p.k nuk ploteson kriteret sipas dekuventave standarte per kapacitete teknike si stafi drejtues teknik, numrin e punonjesve si dhe kapacitetin per makinerit.per kete arsye oferta e saj refuzohet.

3. Oferta e shoqerise, **Rafin Company, shpk me nr.Nipti:L52125110A** me vlere te ofruar:**82.999.999**(tetedhjete e dy milion e nenteqind e nentedhjete e nente mije e nenteqind e nentedhjete e nente) leke pa tvsh, eshte refuzuar per arsyet e meposhtme:

**Operatori ekonomik “Rafin Company” Shpk nuk ploteson kriteret per kualifikim, sipas shtojces 12 te DST me poshte sqaruar:**

Shoqeria Rafin Company sh.p.k nuk ploteson kriteret sipas dekuventave standarte per kapacitete teknike si stafi drejtues teknik, numrin e punonjesve si dhe kapacitetin per makinerit.per kete arsye oferta e saj refuzohet.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë : **BOE : Murati, shpk & Sireta 2F, shpk & EURO-ALB, shpk : Murati** me nr. Nipti: **J66702413V, Sireta 2F me nr. Nipti:K51501008J,Euro-Alb me nr.Nipti:K66613407H,** **adresa: Tiranë,** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej : **82.202.681** (tetedhete edy milion e dyqind e dy mije e gjashteqind e tetedhete e nje) leke pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Adresa: Bashkia Rrogozhine, Lagjia Nr.1, Rruga Kavajes** sigurimine kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit,brenda **30 ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi. Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë, **26.11.2018**

Ankesa: ka ose jo, **nuk ka**

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**KRYETARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Beqir NUREDINI**

